Nr.11243-00374-00-2010 i Regj. Themeltar
Nr.00-2014 – 1350 i Vendimit (175)

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Ardian Nuni	Kryesues
Majlinda Andrea	Anëtare
Guxim Zenelaj	Anëtar
Admir Thanza	Anëtar
Artan Broci	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 24.04.2014, mori në shqyrtim çështjen civile që i përket palëve:

KËRKUES:	S4E GROUP GmHB e përfaqësuar nga avokat Gerhrd Velaj me prokurë.
PERSON I TRETË:	KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPATE e përfaqësuar nga juristi Artan Çela dhe Avokate e Shtetit Brunilda Lila.

OBJEKTI:
Njohja e vendimit përfundimtar të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit,
datë 16.12.2008 dhe të shtojcës së tij, datë 10.04.2009,
për cështjen gjyqësore me palë paditëse S4E GmBH,
i paditur Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH)
me objekt: Detyrimin e të padituri të anulojë aktin e tërheqjes
së garancisë bankare nr.8813G0607639, datë 28.06.2006,
lëshuar nga Banka Austriake Cenditanstalt AG.
Detyrimin e të padituri t'i paguajë shpenzimet ligjore
që lidhen me proçesin gjyqësor të zhvilluar
në Gjykatën e Shkallës së Parë Vjenë dhe atë të Arbitrazhit.
Baza Ligjore: Nenet 393, 395, 396, 397 dhe 399 të K.Pr.Civile.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.114, datë 13.11.2009, ka vendosur:

> "Të njohë dhe japë fuqi për zbatim në Republikën e Shqipërisë vendimit nr.14939 të Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtarë Paris Francë për të gjitha detyrimet e përcaktuara në atë vendim të palëve në proces."

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, në bazë të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, ka ushtruar rekurs Avokatura e Shtetit nëpërmjet Avokates se Shtetit, e cila kërkon prishjen e këtij vendimi dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e apelit me tjetër trup gjykues, duke parashtruar këto shkaqe:

- Gjykata e apelit ka dhënë një vendim duke shkelur rëndë normat procedurale. Në kundërshtim me kërkesat e nenit 4/2 të Konventës së New York dhe 396/b të K.Pr.C, gjykata e apelit ka vendosur njohjen e vendimit, ndërkohë që dokumentet bashkëngjitur kërkesës për njohjen e vendimit mungojnë.
- Gjykata e apelit i është referuar kryesisht nenit 398 të K.Pr.C ndërkohë që dispozitat e Konventës së New York prevalojnë mbi dispozitat e K.Pr.C. Pala kërkuese ka paraqitur një kopje vendimi në gjuhën angleze e cila pas kërkesës së Avokaturës së Shtetit është paraqitur në seancë nga pala kërkuese (e jo siç shprehet gjykata e apelit "nga personi i tretë) e përkthyer nga përkthyes zyrtar i njohur nga Ministria e Drejtësisë.
- Gjykata e apelit ka dhënë një vendim në mungesë të dokumentacionit të kërkuar. Në kuptim të nenit 4/1/b të Konventës së New York pala kërkuese ka dështuar në paraqitjen e një kopje origjinale të kontratës në bazë të së cilës palët kanë rënë dakord që çdo mosmarrëveshje ta zgjidhin përmes Arbitrazhit Ndërkombëtar, si dhe përkthim zyrtar në kuptim të Nenit 2/2 dhe 4.2 të Konventës së New York.
- Gjykata e apelit ka vepruar në kundërshtim me vendimin nr.00-2007-1233(1067), datë 26.09.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë duke mos zbatuar kërkesat e nenit 154, 154/a të K.Pr.Civile duke përfshirë dhe vlerën e kërkesë 1% mbi vlerën e vendimit gjyqësor që kërkohet të njihet.
- Gjykata e apelit në kundërshtim të plotë me ligjin dhe Konventën e New York (neni 5/1, d 5/2, b) dhe Neni 394/dh të K.Pr.Civile i ka dhënë fuqi dhe ka njohur një vendim të huaj arbitrazhi i cili është në kundërshtim me parimet bazë të legjislacionit shqiptar dhe atij francez, për të cilat palët kanë rënë dakord.
- Gjykata e apelit në kundërshtim me nenin 6/1 të KEDNJ-së, 42 të Kushtetutës së R.Sh. dhe parimet themelore të R.Sh-së ka realizuar një proces jo të rregullt ligjor.

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e çështjes nga gjyqtari Admir Thanza; përfaqësuesin e kërkuesit, i cili kërkoi lënin në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit; përfaqësuesit e personit të tretë, që kërkuan prishjen e këtij vendimi dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e apelit, me tjetër trup gjykues; si dhe e diskutuan çështjen në tërësi,

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes:

1. Gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit rezultojnë të pranuara si të vërtetuara rrethanat e faktit si më poshtë cituar.
2. Palët kërkuese Shoqëria "S4E Group GmHB" është një shoqëri gjermane e angazhuar në tregtimin ndërkufitar të energjisë në Europë. Në procedurën e tenderimit ndërkombëtarë organizuar nga personi i tretë Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) për furnizimin me energji elektrike për periudhën Prill-Dhjetor 2006, oferta e shoqërisë "S4E Group GmHB" u shpallë fituese e këtij tenderi.
3. Në këto kushte, më datë 29 Maj 2006 midis Shoqërisë "S4E Group GmHB" me cilësinë e furnizuesit dhe Shoqërisë "KESH" me cilësinë e blerësit është lidhur kontrata për furnizim me energji elektrike për periudhën 1 Korrik 2006 deri më 31 Dhjetor 2006.

4. Në garantim të përmbushjes së detyrimeve, sipas kushteve të kontratës, Shoqëria "S4E Group GmHB" ka pajisur Shoqërinë "KESH" me garancinë bankare nr.8813G0607639, datë 28.06.2006, lëshuar nga Banak Austriake Cenditanstalt AG, të cilën Shoqëria "KESH" duke pretenduar mos përmbushje të detyrimeve kontratuale nga ana e Shoqërisë "S4E Group GmHB" më datë 18 Janar 2007 ka tentuar të tërheqë garancinë bankare nr.8813G0607639, datë 28.06.2006, lëshuar nga Banak Austriake Cenditanstalt AG.
5. Për të parandaluar ekzekutimin e garancisë bankare, Shoqëria "S4E Group GmHB" ka paraqitur kërkesë përpara Gjykatës së Shkallës së parë Vjenë ku me datë 25 Janar 2007 është marrë masa e përkohshme për pezullimin e lirimit të garancisë.
6. Shoqëria "S4E Group GmHB" për zgjidhjen e mosmarrëveshjes lidhur me përmbushjen e detyrimeve kontraktore, në bazë të kontratës, i është drejtuar Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit.
7. Në përfundim të procesit të arbitrazhit, **Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit** me vendimin nr.14939, datë (ICC) 16 Dhjetor 2008 ka vendosur:
   -KESH tërhoqi në mënyrë të pajustifikuar garancinë bankare nr.8813G0607639, datë 28.06.2006, datë 28 Qershor 2006, lëshuar nga Banka Austriake Creditanstalt AG.
   -KESH ngarkohet të anulojë aktin e tërheqjes së kësaj garancie bankare nr.8813G0607639
   -KESH duhet t'i paguaje S4E Group shumën në vlerën 9.017.36 Euro që i përket shpenzimeve që lidhen me procesin gjyqësor në Gjykatën e Shkallës së Parë Vjenë
   -Shpenzimet e Arbitrazhit të përckatuara nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit janë vlerësuar në shumën $ US 290.000
   -KESH duhet të rimbursojë S4E Group 25% të këtyre shpenzimeve në shumën $US 72.500.00 dhe shumën $ US6.631.20 persa i përket mbulimit të vlerës së TVSH-së mbi shumën e mësipërme.
   -KESH duhet ti rimbursojë S4E Group në masën 25% të shpenzimeve të arsyeshme ligjore dhe shpenzimeve të tjera të shkaktuara nga S4E Group në këtë arbitrazh në masën 93.215.45 Euro.
   -Kundërpadia e KESH dhe të gjitha pretendimet e tjera nuk pranohen.
8. Më datë 22 Janar 2009 Personi i Tretë KESH i është drejtuar Sekretarisë së Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit me kërkesë për korrigjim dhe interpretim të vendimit të arbitrazhit datë 16 Dhjetor 2008. Me shtojcën e vendimit datë 10 Prill 2009, nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit është vendosur refuzimi i kërkesë për interpretim të vendimi për aq sa ajo në thelb kërkon një rishikim të çështjes dhe ka pranuar pjesërisht kërkesën për korrigjim.
9. Në të tilla rrethana, pala paditëse gjyq fituese, S4E Group GmBH në cilësinë e kërkuesit, i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë me kërkesë për njohjen dhe dhënien fuqi të vendimit nr.14939, datë (ICC) 16 Dhjetor 2008 të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit.
10. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.114, datë 13.11.2009, ka vendosur:
    " *Të njohë dhe japë fuqi për zbatim në Republikën e Shqipërisë vendimit nr.14939 të Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtarë Paris Francë për të gjitha detyrimet e përcaktuara në atë vendim të palëve në proces."*
11. Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar: *"...omissis...Midis palëve në proces ka patur një kontratë dhe me vullnetin e tyre të brendshëm kanë pranuar pikërisht arbitrazhin e*

Dhomës së Arbitrave Ndërkombëtar në Paris Francë (neni) 9 i kontratës).palët kanë qenë të pranishëm dhe veç kësaj personi i tretë KESH sh.a ka kërkuar dhe korrigjim dhe interpretim të vendimit, ky gjykata e Arbitrazhit është investuar përsëri në lidhje me kërkesën nga ku ka dalë dhe shtojca e vendimit. Në vendin tonë është në fuqi ligji nr.8688, datë 09.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për njohjen e vendimeve të huaja dhe arbitrazhit". Po kështu kemi aderuar dhe në Konventën Europiane të Arbitrazhit, Konventë kjo e Gjenevës e datës 21.05.1961, aderimi i të cilës është bërë me ligjin nr.8687, datë 09.11.2000. Pretendimi i avokates së shtetit:"se nuk është mbajtur procesverbal në seancë dëgjimore" ndaj procesi është i parregullt, gjendet i pabazuar nga gjykata e apelit. Në kuptimin e parimit bazë të legjislacionit shqiptar të parashikuar në germën "Dh' të nenit 394 , është respektuar plotësisht parimi i kontradiktorialitetit i parashikuar në nenin 18 të Kodit të Procedurës Civile, i cili ka sanksionuar: "Asnjë palë nuk mund të gjykohet pa u dëgjuar ose pa u thirrur në gjykim". Në rastin në gjykim pala është thirrur është dëgjuar si dhe nga vetë Arbitrazhi Ndërkombëtar është marrë në shqyrtim pretendimi i ngritur nga pala për procesverbalin në seancën dëgjimore. Për sa sipër nga ana e gjykatës çmohet plotësisht e bazuar kërkesa e kërkuesit S4E Group GMBH për njohjen dhe dhënien fuqi të vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar, pasi nuk përmban asnjë nga pengesat ligjore të parashikuara në nenin 394 të Kodit të Procedurës Civile dhe është në përputhje me ligjet e vendit dhe konventat ndërkombëtare ku vendi ynë ka aderuar, si dhe gjykata e apelit ka pengesë ligjore për të marrë në shqyrtim probleme themeli të çështjes të ngritura nga përfaqësuesja e Avokaturës së Shtetit në seancë.(...)."

12. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, në mbështetje të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, ka ushtruar rekurs Avokatura e Shtetit duke parashtruar shkaqet e treguara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

II. Ligji i zbatueshëm:

13. Kodit i Procedurës Civile parashikon se:

13.1. **Neni 395:**

"Kërkesa për t'i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj i paraqitet gjykatës së apelit. Kërkesa mund të paraqitet edhe në rrugë diplomatike kur ajo është e lejueshme nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe mbi bazën e reciprocitetit.

Në këto raste, në qoftë se pala e interesuar nuk ka emëruar përfaqësues, kryetari i gjykatës së apelit emëron një avokat për të paraqitur kërkesën.

13.2. **Neni 396:**

"Kërkesës për t'i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj duhet t'i bashkëngjiten:

a. kopja e vendimit që duhet të zbatohet dhe përkthimi i tij në gjuhën shqipe i legalizuar nga noteri;

b. vërtetim nga gjykata që e ka nxjerrë vendimin se ai ka marrë formë të prerë, si edhe përkthimi e legalizimi noterial i tij. Si kopja e vendimit, ashtu edhe vërtetimi se vendimi ka marrë formë të prerë, duhet të jenë vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë;

c. prokura, në rast se kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i të interesuarit, e përkthyer dhe e legalizuar te noteri”.

14. Ligji nr.8688, datë 09.11.2000 *“Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Njohjen e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit Ndërkombëtar”*. Konventa e Nju Jorkut ku parashikohet se:

14.1. ***Neni 4:***

1. *“Për të siguruar njohjen dhe ekzekutimin e vendimit siç përmendet në nenin e mësipërm, pala që kërkon njohjen dhe ekzekutimin duhet të paraqesë, në të njëjtën kohë me kërkesën, sa vijon:*

a) origjinalin e vendimit të arbitrazhit, të vërtetuar rregullisht ose një kopje të vërtetuar në mënyrën e duhur;

b) origjinalin e marrëveshjes me shkrim të parashikuar në nenin 2 ose një kopje të vërtetuar në mënyrën e duhur.

2. Në qoftë se vendimi ose marrëveshja në fjalë nuk është hartuar në një gjuhë zyrtare të vendit ku jepet vendimi, pala që kërkon njohjen dhe ekzekutimin e vendimit duhet të paraqesë një përkthim të këtyre dokumenteve në ato gjuhë. Përkthimi duhet vërtetuar nga një përkthyes zyrtar, ose një përkthyes i betuar, ose nga një agjent diplomatik apo konsullor”.

III. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se:

15. Pala që ka regjistruar *ankimin,* konkretisht Avokatura e Shtetit legjitimohet *ratione personae* t’i drejtohen Gjykatës së Lartë lidhur sa më sipër.
16. Rekursi është paraqitur brenda afatit ligjor, ndaj edhe legjitimohet *ratione temporis.* Gjithashtu rezulton se *ankimi* i është njoftuar palëve të tjera ndërgjyqëse.
17. Në lidhje me thelbin (legjitimimi *ratione materiae*), Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se rekursi i paraqitura nga Avokatura e Shtetit përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile që motivojnë cenimin e vendimit nr.114, datë 13.11.2009, të Gjykatës së Apelit Tiranë.
18. Gjykata e Lartë, pa i hyrë analizës së provave, nga shqyrtimi i materialeve të dosjes gjyqësore, pretendimeve të parashtruara në rekurs evidenton nëse nga gjykata e apelit janë lejuar ose jo shkelje të normave procedurale dhe nëse ligji material është respektuar ose jo. Në varësi të zgjidhjes së këtyre çështjeve nga gjykata e faktit, Gjykata e Lartë, në realizim të funksionit të saj rishikues, shprehet për bazueshmërinë ose jo në ligj të vendimit të gjykatës së apelit.
19. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në shqyrtim e në vlerësim të akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore e të administruara gjatë gjykimeve, pretendimeve e prapësimeve të palëve, vendimeve të gjykatave të faktit, si dhe referuar shkaqeve të rekursit, vlerëson se arsyetimi dhe përfundimi i arritur nga gjykata e apelit është rrjedhojë e mosrespektimit dhe zbatimit të gabuar të kërkesave të ligjit procedural.
20. Duke qenë se zhvillon një gjykim të natyrës fillestare, sikurse çdo gjykatë e shkallës së parë, gjykata e apelit zbaton rregullat procedurale për verifikimin e rregullshmërisë formale të paraqitjes së kërkesës për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj. Nëse ka mangësi dhe të meta, gjykata e apelit i cakton kërkuesit një afat të arsyeshëm për plotësimin e tyre, në të kundërt i kthen kërkesën dhe aktet e tjera pa veprim të mëtejshëm.

21. Këto verifikime, gjykata e apelit i realizon me paraqitjen e kërkesës ose në kuadër të veprimeve përgatitore, kryesisht apo me kërkesën e palëve.
22. Në fazën e dytë, pra nëse kërkesa për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj apo gjykatës së huaj të arbitrazhit përmbush kushtet për rregullshmërinë formale-procedurale të paraqitjes së saj, gjykata e apelit cakton seancën gjyqësore në të cilën objekti i gjykimit është vetëm ekzistenca ose jo e ndonjërës prej pengesave dhe ndalimeve ligjore të parashikuara nga neni 394 i Kodit të Procedurës Civile, neni 5 i Konventës së Nju Jorkut apo nga ndonjë dispozitë tjetër e posaçme për këtë qëllim, e parashikuar nga ligji ose një marrëveshje tjetër ndërkombëtare.
23. Pasi ka dëgjuar argumentet dhe prapësimet përkatëse të palëve ndërgjyqëse, në përfundim të gjykimit, gjykata e apelit vendos për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj apo gjykatës së huaj të arbitrazhit.
24. Sipas nenit 396 të Kodit të Procedurës Civile, pala kreditore që kërkon dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj ka vetëm detyrimin që t'i paraqesë gjykatës kopjen e vendimit që duhet të zbatohet, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të legalizuar nga noteri, vërtetimin nga gjykata që e ka nxjerrë vendimin se ai ka marrë formë të prerë, si edhe përkthimin e legalizimin noterial të tij. Të dy këto akte me shkresë duhet të paraqiten të vërtetuara nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë. Së fundi, pala kërkuese ka edhe detyrimin të paraqesë në gjykatën e apelit prokurën, në rast se kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i të interesuarit, edhe kjo e përkthyer dhe e legalizuar nga noteri.
25. Konventa e Nju Jorkut, në nenin 4 të saj (të cituar në pikën 19.3 të vendimit unifikues nr.6, datë 01.06.2011, të Kolegjeve të Bashkuara), për sa i përket akteve që duhet t'i bashkëlidhen kërkesës për njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja të arbitrazhit, parashikon rregulla e kushte të ngjashme me ato të nenit 396 të Kodit Procedurës Civile. Por dispozita e nenit 4 të Konventës, në shkronjën "b" të pikës 1 të tij, përmban edhe një kusht të posaçëm dhe të rëndësishëm, sipas të cilit, pala kërkuese ka detyrimin që të paraqesë bashkëlidhur kërkesës për njohje të vendimit të gjykatës së arbitrazhit të huaj edhe origjinalin apo kopjen e vërtetuar rregullisht të marrëveshjes me shkrim për arbitrazh të lidhur mes palëve ndërgjyqëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në gjykim.
26. Sikurse parashtrohet më sipër në pikat 19 deri 19.5 të këtij vendimi unifikues, qysh me paraqitjen e kërkesës apo nëpërmjet veprimeve përgatitore, gjykata e apelit, edhe kryesisht, pra edhe pa thirrjen, praninë apo dëgjimin e qëndrimit të palës debitore, është në gjendje, madje ka detyrimin ligjor, që të verifikojë nëse kërkesa për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj është e plotësuar duke përmbajtur bashkëlidhur aktet që tregohen shprehimisht në nenin 396 të Kodit të Procedurës Civile.
27. Në rastin e njohjes së vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit, nëse nuk ka marrëveshje tjetër ndërkombëtare që parashikon ndryshe, kërkesa drejtuar gjykatës shqiptare të apelit duhet të plotësojë edhe të gjitha kushtet që përmbahen në nenin 4 të Konventës së Nju Jorkut. Edhe pse shteti i palës kërkuese mund të mos jetë palë në këtë Konventë, gjykata e apelit, nga ana e saj, në mungesë të rregullimeve të tjera normative të posaçme, duhet t'i përmbahet standardeve dhe kritereve të vendosura nga kjo Konventë.
28. Në vendimin nr.14939, datë (ICC) 16 Dhjetor 2008 të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit në çështjen me palë ndërgjyqëse S4E Group GmBH kundër Korporata

Elektroenergjitike Shqiptare në pikën I Procedura, 1.1 Marrëveshja e Arbitrazhit ka pranuar kompetencën e saj bazuar në nenin 9 të (KSK) Kontratës e cila ka parashikuar: *" Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë përmbushjes së kontratës do të zgjidhen me mirëkuptim ose do të zgjidhen si më poshtë: ii. Në rast se mosmarrëveshjet ekzistojnë ndërmjet blerësit dhe një furnizuesi të jashtëm, ato do të zgjidhen përmes Dhomës së Arbitrazhit- Paris."*

29. Përsa sipër ky kolegj konstaton se gjykata e apelit në njohjen dhe dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj dhe në rastin konkret të vendimit nr.14939, datë (ICC) 16 Dhjetor 2008 të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit në zbatim të nenit 393/2 të Kodit të Procedurës Civile dhe Konventës së Nju Jorkut nuk ka administruar si provë Kontratën ndërmjet palëve e cila ka parashikuar gjykatën kompetente për zgjidhjen e konfliktit ndërmjet palëve.
30. Në vendimin unifikues nr.6, datë 01.06.2011, Kolegjet e Bashkuara kanë arritur në përfundimin se: "*...omissis...****Në shqyrtimin e kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj apo të gjykatës së huaj të arbitrazhit, gjykata e apelit zbaton rregullat e gjykimit të shkallës së parë.***

    Mes të tjerave, sikurse vepron gjykata e shkallës së parë, me paraqitjen e kërkesëpadisë apo edhe nëpërmjet kryerjes së veprimeve përgatitore, gjykata e apelit paraprakisht verifikon përmbushjen e kushteve dhe kritereve formale të paraqitjes së kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj ose të gjykatës së huaj të arbitrazhit. Posaçërisht, gjykata e apelit verifikon nëse kërkesa, sipas rastit, plotëson kushtet paraprake formale të parashikuara nga neni 395 e 396 i Kodit të Procedurës Civile, neni 4 i Konventës së Nju Jorkut apo që përmbahen në ligje të tjera të posaçme ose akte të së drejtës ndërkombëtare të zbatueshme për çështjen në gjykim.

    Nëse kërkesa për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj ose të gjykatës së huaj të arbitrazhit ka mangësi dhe të meta, gjykata e apelit i cakton kërkuesit një afat të arsyeshëm për plotësimin dhe ndreqjen e tyre. Gjykata e apelit kthen kërkesën dhe aktet e tjera pa veprim, nëse pala kërkuese, brenda afatit që i është caktuar, nuk plotëson dhe ndreq mangësitë dhe të metat formale të kërkesës.

    Nëse kërkesa për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj apo të gjykatës së huaj të arbitrazhit përmbush kushtet për rregullshmërinë formale-procedurale të paraqitjes së saj, gjykata e apelit cakton seancën gjyqësore në të cilën objekti i gjykimit është vetëm ekzistenca ose jo e ndonjërës prej ndalimeve a pengesave ligjore të parashikuara nga neni 394 i Kodit të Procedurës Civile, neni 5 i Konventës së Nju Jorkut apo nga ndonjë dispozitë tjetër e posaçme për këtë qëllim, e parashikuar nga ligji ose një marrëveshjeje ndërkombëtare. Në përfundim të gjykimit, gjykata e apelit vendos për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj apo gjykatës së arbitrazhit të huaj.(…).
31. Në rigjykim, gjykata e apelit duhet të realizojë të gjitha veprimet procedurale që lidhen me plotësimin nga ana e palës kërkuese të kushteve që ligji procedural parashikon për paraqitjen e kërkesëpadisë, në veçanti Kontratën ndërmjet palëve e cila ka parashikuar Gjykatën Kompetente për zgjidhjen e konfliktit, duke mbajtur parasysh edhe veçantitë përkatëse të rastit të paraqitjes së kërkesës për njohje të vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit.

32. Kështu, neni 4 i Konventës së Nju Jorkut, në shkronjën “b” të pikës 1 të tij, përmban një kusht tjetër për rregullshmërinë formale të paraqitjes së kërkesës për dhënien fuqi të një vendimi të gjykatës së huaj të arbitrazhit. Sipas kësaj dispozite, në kërkesën drejtuar gjykatës së shtetit ku kërkohet dhënia fuqi e vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit duhet të paraqitet e bashkëlidhur edhe: ***“origjinali i marrëveshjes me shkrim të parashikuar në nenin 2, ose një kopje të vërtetuar në mënyrën e duhur”***. Neni 2 i Konventës ku referohet ky kusht paraprak për pranueshmërinë për shqyrtim në themel të kërkesës parashikon se: *“Termi "marrëveshje e shkruar" do të përfshijë një klauzolë arbitrazhi në një kontratë, ose në një marrëveshje arbitrazhi e nënshkruar nga palët ose që përmbahet në një shkëmbim letrash ose telegramesh”*.
33. Në Kodin e Procedurës Civile nuk parashikohet shprehimisht një kusht i tillë paraprak për pranueshmërinë për gjykim të kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit. Por, në zbatim të nenit 122 të Kushtetutës, prevalon e zbatohet drejtpërdrejt rregullimi që përmban marrëveshja ndërkombëtare, pra dispozita e posaçme e shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 4 të sipërcituar të Konventës së Nju Jorkut.
34. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konstaton se kërkesës së paraqitur për gjykim për dhënie fuqi të vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit nuk i është bashkëlidhur origjinali i marrëveshjes së arbitrazhit,(kontratës në rastin në gjykim) apo kopje e saj e vërtetuar rregullisht. Marrëveshja e arbitrazhit nuk mund të pranohet se ekziston thjesht nisur nga përmbajtja e vendimit të gjykatës së arbitrazhit që paraqitet për t’i dhënë fuqi në Republikën e Shqipërisë.
35. Verifikimin e plotësimit të kërkesës për dhënie fuqi të vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit duke i bashkëlidhur origjinalin apo kopjen e vërtetuar rregullisht të marrëveshjes me shkrim për arbitrazh, Gjykata e Apelit Tiranë duhet ta kishte përmbushur qysh me paraqitjen e kërkesës për njohje apo në veprimet përgatitore.
36. Sikurse arsyetohet më sipër në këtë vendim, në rrethanat kur kërkesës për njohje të vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit nuk i është bashkëlidhur edhe marrëveshja me shkrim e arbitrazhit në origjinal apo kopje e saj e vërtetuar rregullisht, (marrëveshje e cila mund të jetë parashikuar dhe në kontratën ndërmjet palëve) sikurse është parashikuar posaçërisht nga shkronja “b” e pikës 2 të nenit 4 të Konventës së Nju Jorkut, atëherë nuk është ezauruar njëri nga kushtet paraprake për pranueshmërinë për shqyrtim në themel të kësaj kërkese, pa plotësimin e të cilës nuk mund të vijohet me shqyrtimin e ndalesave a pengesave të tjera ligjore për njohjen e vendimit të huaj në Republikën e Shqipërisë.
37. Në të tilla rrethana, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konkludon që, në rigjykim, gjykata e apelit duhet të realizojë veprimet përkatëse procedurale për t’i mundësuar palës kërkuese plotësimin e kërkesës edhe me këtë akt, duke e paraqitur atë rregullisht e në afatin që do t’i caktohet nga gjykata e apelit.
38. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë për njohje të vendimit të arbitrazhit të huaj është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit procedural civil dhe për pasojë ky vendim duhet të prishet dhe bazuar në nenin 485/c të Kodit të Procedurës Civile çështja duhet dërguar për rishqyrtim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 485/c të Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S I

Prishjen e vendimit nr.114, datë 13.11.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim po asaj gjykate, me tjetër trup gjykues.

Tiranë, më 24.04.2014